



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok.20200601/11

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandim për identifikimin dhe fillimin e hetimit penal të punonjësve të Policisë së Shtetit, për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare", parashikuar nga nenet 250 e 25 të Kodit Penal, për veprimet e kundërligjshme të kryera ndaj shtetases ****

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË**

**SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT
TIRANË**

**Për dijeni: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
TIRANË**

Të nderuar,

Sikurse jeni në dijeni nga komunikimet shkresore, në institucionin e Avokatit të Popullit është paraqitur ankesa e shtetases ***, në përmbajtje të së cilës ajo ka deklaruar se ndaj saj është ushtruar dhunë nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, pjesë të Forcave Shqiptonja dhe Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë, ditën e protestës së datës 11 maj 2019, organizuar nga subjekti Partia Demokratike dhe koalicioni.

Në vijimësi, Avokati i Popullit ka monitoruar protestat e organizuara nga subjekte të ndryshëm, si persona fizikë dhe juridikë duke shprehur shqetësim për qasjen e punonjësve të Policisë së Shtetit ndaj protestuesve, edhe pse ka kërkuar në mënyrë të përsëritur që organet e policisë të garantojnë me të gjitha mënyrat që qytetarët të shprehin pakënaqësitë e tyre në mënyrë paqësore, të pashqetësuar e të pavënë nën presion të çdo lloji.

Me qëllim shqyrtimin dhe verifikimin e ankesës së shtetasës ***, institucioni ynë ka zhvilluar një hetim administrativ, në kuadër të së cilit janë kryer një sërë veprimesh, duke përfshirë edhe mbajtjen e një korrespondence të zgjeruar me institucionet e përfshira. Kjo është shtrirë edhe në kohë, duke u bërë pengesë për finalizimin e rekomandimit.

Kështu, fillimisht, është kërkuar kryerja e ekspertizës mjeko-ligjore të ankueses nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.

Në dëshminë mjeko-ligjore nr.423 mbi ekzaminimin e shtetasës *** të kryer nga Instituti i Mjekësisë Ligjore rezulton se:

“Në momentin e ekzaminimit, objektivisht gjendja e përgjithshme paraqitet e mirë. Ankon për dhimbje trupore në vendin e goditjeve, dhimbje të supit të djathtë si dhe kufizim të lëvizjeve të anësisë së sipërme rreth këtij artikulacioni. Lokalisht vërehet ekimozë me ngjyrë të errët në jeshile e lokalizuar në supin e djathtë më përmasa 4x3 cm, e dhimbshme në prekje dhe shtypje me gisht. Në anën e brendshme të krahut afër sqetullës së djathtë vërehen tre ekimozë në trajtë elipsi me diametër 3x2 cm, me ngjyrë të errët jeshile. Në supin e majtë vërehet një ekimozë në trajtë vezake me përmasa 5x3,5 cm, me ngjyrë të errët në jeshile që është e dhimbshme në shtypjen me gisht. Në shpatullën e majtë vërehet një ekimozë me përmasa 6x4 cm, me ngjyrë të errët në jeshile. Në kurriz në nivelin e vertebrave lumbare në anën e djathtë të kolonës vërehet një ekimozë tjetër me të njëjtat karakteristika me përmasa 5x4 cm, në nivelin e gjurit të majtë nga ana e jashtme vërehet një ekimozë me përmasa 6x4 cm, me ngjyrë të zezë në jeshile.

Duke u mbështetur në të dhënat e mësipërme arrijmë në përfundimin se:

- a) Tek shtetasja e dëmtuar ***u konstatuan disa ekimozë me karakteristikat dhe lokalizimet e lartpërmendura.*
- b) Dëmtimet janë shkaktuar nga mjete të forta mbretëse.*
- c) Nisur nga karakteristikat e dëmtimeve rezulton se ato janë shkaktuar në kohën e deklaruar nga e dëmtuara (datë 11.05.2019).*
- d) Këto dëmtime hyjnë në katëgorinë e atyre dëmtimeve të cilat japin paaftësi të përkohshme për punë në masën deri në 9 (nëntë) ditë.”*

Kjo dëshmi mjeko-ligjore së bashku me pamjet filmike që kanë qarkulluar në media lidhur me këtë rast të datës 11 maj 2020, janë dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit i jemi drejtuar me shkresat nr.K2/A35-3 prot., datë 29.05.2019 dhe nr.K2/A35-6 prot., datë 21.06.2019, ku kemi kërkuar informacion për identifikimin e punonjësve të policisë që janë konfliktuar me shtetasen ***, si dhe mundësimin e marrjes së deklaratave të tyre në institucionin e Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, është kërkuar informacion për përbërjen (llojin) e lëndëve lakrimogjene të përdorura nga Policia e Shtetit në datë 11.05.2019, numrin e granatave ose çdo lloj forme tjetër të lëshimit të këtyre lëndëve dhe shpeshësinë e intervaleve të hedhjes sipas vendeve të zhvillimit të protestës, duke u shoqëruar informacioni me certifikatën e cilësisë, garancisë, si dhe deklaratën e përputhshmërisë (konformitetit).

Me shkresën nr.4591/1 prot., datë 06.06.2019 Policia e Shtetit është shprehur se në të gjitha tubimet e dhunshme, ku kanë mbetur të plagosur shumë punonjës policie, ka operuar sipas Procedurave Standarde të Veprimit. Për çdo rast të kapërcimit të këtyre procedurave, janë bërë analiza dhe janë dhënë masa ndëshkuese për cilindo punonjës policie.

Nga ana e Policisë së Shtetit nuk pranohet se punonjësit e policisë të jenë konfrontuar fizikisht me turmën e protestuesve të dhunshëm, apo me persona të mitur.

Gjithashtu, në përgjigjen e dërguar Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit na informon se *“lidhur me protestën e datës 11.05.2019, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar dhe po zhvillon hetime si për personat e dhunshëm, ashtu edhe për reagimin e punonjësve të policisë.*

Edhe materiali filmik i dërguar nga ana juaj, është pjesë e hetimit të gjerë për këtë çështje.”

Me shkresën nr.K2/A35-4 prot., datë 29.05.2019 i është kërkuar informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, nëse është filluar hetimi disiplinor për veprime të kundërligjshme të punonjësve të policisë për këtë rast, nëse nga hetimi i deritanishëm janë identifikuar këta punonjës, janë sqaruar rrethanat e ndodhjes së ngjarjes dhe a është arritur në përfundime konkrete nga hetimi disiplinor i personave përgjegjës që kanë kryer shkeljen.

Me shkresën nr.1225/1 prot., datë 28.06.2019 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat na informon si më poshtë vijon:

“Duke u nisur nga problematikat e krijuara gjatë zhvillimit të protestave të opozitës në qytetin e Tiranës, në përmbushje të detyrave tona ligjore dhe institucionale, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, ka ngritur grupin e inspektimit, i cili do të bëjë evidentimin, trajtimin dhe vlerësimin e masave të ndërmarra nga strukturat policore para, gjatë dhe pas protestave të opozitës të zhvilluara gjatë periudhës maj-qershor 2019.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se në lidhje me këto protesta, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr.3687/2019. Sipas Urdhrit të delegimit të prokurorëve për këtë procedim penal, janë OPGJ-të e SHÇBA-së që do të zbatojnë detyrat e deleguara.

*Po ashtu, zonja *** i është drejtuar Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat me ankesën nr.A-195 prot., datë 18.06.2019, e cila është trajtuar nga ana jonë dhe ankueses i është kthyer përgjigje me datë 25.06.2019.”*

Në vijim, me shkresën nr.K2/A35-10 prot., datë 18.11.2019 i është kërkuar informacion Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila në përgjigjen nr.17231/1, datë 9.01.2020 jep këtë sqarim:

“Procedimi penal nr.3687 i vitit 2019 aktualisht është në hetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë procedim po hetohet edhe për veprën penale të “kryerja e veprimeve arbitrare” të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal në lidhje me veprimet e punonjësve të policisë së shtetit në kohën e protestës, pasi ka pasur pretendime për dhunë të ushtruar nga policia ndaj protestuesve. Nga ana jonë po kryhen shumë veprime

hetimore si pyetja e punonjësve të policisë, protestuesve në këto protesta si dhe janë marrë shumë prova të tjera, si akte ekspertimi etj.

Në përfundim të hetimit do të procedohet në një nga mënyrat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Peale.”

Avokati i Popullit i është drejtuar sërish Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat si në rrugë elektronike me email, ashtu edhe me shkresat përkatësisht me nr. K2/A35-13 prot., datë 20.05.2020 dhe nr. K2/A35-14 prot., datë 20.05.2020, duke ripërsëritur vëmendjen që institucioni ynë i ka kushtuar rastit në fjalë, si dhe duke ritheksuar rëndësinë e ndarjes së procedimeve. Është kërkuar informacion nëse janë kryer veprime hetimore ndaj punonjësve të policisë në rastin e znj. ***, si dhe nëse pjesë e procedimit nr.3687 të vitit 2019, janë si hetimet për veprën penale “kryerja e veprimeve arbitrare” ashtu edhe “kundërshtim i punonjësit të policisë” ku po hetohen edhe protestuesit.

Ndërkohë në përgjigjen nr.5736/1, datë 15.06.2020 të organit të prokurorisë referohet se:

“...në funksion të procedimit penal nr.3687, datë 20.05.2019 është bërë urdhri për kryerjen e veprimeve hetimore të regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 150, 151, 236/2, 237, 250, 262 dhe 282/1 të Kodit Penal.

Për kryerjen e veprimeve hetimore përveç policisë gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Policisë është ngarkuar edhe policia gjyqësore e SHÇBA-së e cila nuk ka relatuar për veprimet hetimore të kryera nga ana e saj. Është njoftuar zyrtarisht dhe në momentin e ardhjes së tyre do të merrni informacionin e kërkuar”.

Ndërsa, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat¹ na ka informuar se kjo strukturë me Urdhër nr.123, datë 31.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm ka zhvilluar inspektimin me objekt: *“Evidentimi, analizimi dhe vlerësimi me objektivitet i performancës së strukturave të Policisë së Shtetit si dhe zbatimin e procedurave standard të punës në menaxhimin e protestave të organizuara nga opozita në datat 16.02.2019, 16.03.2019, 13.04.2019, 11.05.2019, 13.05.2019, 25.05.2019, dhe 02.06.2019, në zbatim edhe të procedimit penal nr.3687/2019 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë”.*

Ky inspektim kishte për qëllim vlerësimin e veprimeve të punonjësve të policisë, respektimin e kuadrit ligjor për tubimet; procedurave standarde të punës së Policisë së Shtetit duke u fokusuar edhe në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në përfundim të inspektimit për strukturat e policisë së Shtetit janë dhënë rekomandimet përkatëse duke përfshirë edhe rekomandimin e hetimit disiplinor për disa punonjës të policisë, të cilët kanë tejkaluar kompetencat ligjore në përdorimin e forcës së panevojshme apo për shkelje të të drejtave të disa shtetasve të shoqëruar, të cilët janë mbajtur në ambientet policore në tejkalim të afatit ligjor prej 10 orësh., raport i cili i është dërguar për analizim, vlerësim dhe marrje masash Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Ndër të tjera SHÇBA-ja referon se *“pretendimet e shtetases ***, në lidhje me veprimet e kundërligjshme të punonjësve të Policisë së Shtetit janë duke u hetuar në kuadër të*

¹ Shkresa me Nr.E-62/1 Prot, datë 26.06.2020.

procedimit penal nr.3687/2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “veprime arbitrare” parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal”.

Sipas pamjeve filmike të marra nga mediat, vihet re se mbrëmjen e datës 11 maj 2019, në shëtitoren përballë hyrjes së Parlamentit, janë vendosur një numër i konsiderueshëm i forcave “Shqiponja” të pajisura me maska kundërgazi. Znj. *** së bashku me dy gazetarë gjenden aty pranë. Asaj i afrohet një turmë e madhe punonjësish policie dhe dy prej tyre e shtyjnë me forcë, edhe pse ajo nuk bën rezistencë.

Më pas, pas zhvendosjes së protestës përballë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në tunelet e rrugës “Myslym Shyri”, duket një numër aspak proporcional i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë në raport me numrin e pakët të protestuesve, duke shfaqur një gjuhë urrejtjeje dhe duke bërë titur: “*Kapini dhe bjeruni*”. Një punonjës i policisë konfliktohet me znj. ***.

Në vlerësim të sa më sipër, konstatohet se punonjësit e policisë nuk kanë pasqyruar sjellje etike e profesionale në kryerjen e detyrës, e manifestuar kjo në tejkallim të ushtrimit të forcës, veprime që përbëjnë cenim të integritetit fizik dhe psikologjik të shtetasës ***, të mbrojtur e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Kodi Penal, ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në përfundim të hetimit administrativ të këtij rasti dhe nga provat shkresore të administruara nga ana jonë sikurse janë: Akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr.423 dërguar me shkresën Nr.423 Regj. datë 16.05.2019; Pamjet filmike të konfrontimit të punonjësve të policisë me shtetasen *** në protestën e datës 11.05.2019, arrijmë në konkluzionin se, nga punonjësit e policisë janë konsumuar elementët e veprës penale të “Kryerja e veprimeve arbitrare” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar.

Kjo mënyrë sjelljeje e punonjësve të policisë, vjen në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, ku shprehimisht parashikohet se: “*Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut*”; si dhe të nenit 94 të tij ku parashikohet se “*Punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave.....*”

Në rastin e marrë në shqyrtim, vlerësojmë se organi i prokurorisë duhet të reflektojë në respektimin më të mirë të të drejtave të njeriut, për të sqaruar pozitën procedurale si të autorit të dyshuar, për kryerjen e veprës penale, ashtu dhe ndaj punonjësve të policisë që kanë ushtruar forcë, me qëllim për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme. Është detyrimi ligjor i organit të Prokurorisë, për të kryer hetime të gjithanshme dhe objektive për të verifikuar pretendimet e personave nën hetim, për sjellje dhe veprime të paligjshme të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, si dhe për të hetuar rrethana dhe fakte që janë në favor të personave ndaj të cilëve zhvillohen hetimet.

Nga institucioni i Avokatit të Popullit në vijimësi janë dërguar një sërë rekomandimesh, duke evidentuar shkeljet e konstatuara të së drejtës së shtetasve për të tubuar paqësisht, për cenimin e integritetit fizik dhe mostrajtimin me dinjitet, si dhe mungesën e sjelljes

korrekte dhe etike nga ana e punonjësve të policisë, të fyerjes apo edhe të ushtrimit të forcës fizike ndaj personave të ndryshëm.

Po ashtu, sjellim në vëmendje Raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT) të Këshillit të Evropës, i bërë publik në datën 17.09.2019,² në të cilin është rekomanduar që autoritetet shqiptare duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga punonjësit e policisë. Në veçanti, duhet t'u silltet në vëmendje punonjësve të policisë se të gjitha format e keqtrajtitimit (përfshirë dhunën verbale) janë të paligjshme dhe do të dënohen në përputhje me rrethanat.

Oficerët e policisë gjithashtu duhet të trajnohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është e nevojshme kur kapin një person dhe pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij.

Bazuar në parashikimet e nenit 94 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, *“Punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave.”*

Policia e ushtron veprimtarinë e saj ekskluzivisht në bazë dhe në zbatim të ligjit, në interes të personave, të komunitetit, në mbështetje të institucioneve shtetërore, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe dinjitetit njerëzor, të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, në Kodin Evropian të Etikës së Policisë, si dhe në akte të tjera ndërkombëtare, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, mosdiskriminimit, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, proporcionalitetit, pavarësisë operationale, paanshmërisë politike, integritetit, meritës dhe profesionalizmit, transparencës, ruajtjes së informacionit të klasifikuar, kontrollit dhe llogaridhënies.

Policia nuk përdor dhe nuk toleron torturën, trajtimin çnjerëzor apo degradues. Përdorimi i forcës fizike, mjeteve speciale dhe armëve të zjarrit pranohet në mënyrë proporcionale dhe në përputhje të ngushtë me ligjin, vetëm në rast se mënyrat e tjera jo të dhunshme nuk sigurojnë përmbushjen e attributeve të Policisë.

Gjithashtu, Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave duhet të ushtrojë detyrën me përgjegjshmëri dhe në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij për: a) parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, si dhe të shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj; b) inspektimin dhe trajtimin e ankesave ndaj punonjësve të strukturave për mospërmbushje të detyrës, sipas standardeve të miratuara me akte normative, për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjit; c) ruajtjen e integritetit të punonjësve të strukturave etj.

Ndërsa në pjesën e raportit për organin e prokurorisë Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT), ka bërë rekomandime konkrete³, në lidhje me faktin se hetimet nga prokuroria për rastet e dhunës, duhet të

² CPT ka bërë publik në datën 17.09.2019, raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018.

<https://ëëë.coe.int/en/ëëb/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

³ Po aty, <https://ëëë.coe.int/en/ëëb/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

hetohen me shpejtësi e efikasitet dhe të ndara nga hetimet për akuzat e ngritura ndaj personit në konflikt me ligjin, ndaj të cilit është ushtuar dhunë.

Në përgjithësi, CPT ka vërejtje për faktin se shqyrtimi i pretendimeve, për keqtrajtim të policisë, i kishte kaluar të njëjtit prokuror, që ishte përgjegjës për hetimin penal kundër personit, i cili pretendohet se është keqtrajtuar.

Punonjësit e policisë në të gjitha nivelet duhet të jenë të vetëdijshëm se qeveria është e vendosur të pengojë keqtrajtimin e personave të privuar nga liria, duke forcuar përgjegjshmërinë e policisë dhe duke hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim.

Ndër të tjera, në pikën 15 të raportit përshkruhet se, përbërës thelbësor i çdo strategjie, për të parandaluar keqtrajtimin është shqyrtimi i kujdesshëm nga autoritetet kompetente, i të gjitha ankesave për keqtrajtim dhe dhënia e një dënimi të përshtatshëm. Nëse, nuk ka reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj një të dhëne për keqtrajtim, personat e cenuar shpejt do të besojnë se këto shkelje nuk ndëshkohen. Në mënyrë që hetimi mbi keqtrajtimin e mundshëm të policisë të jetë efektiv, procedura duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Hetime të tilla, duhet të përputhen ndër të tjera me kriterin e shpejtësisë, tërësisë dhe gjithëpërfshirjes.

Policimi konsiderohet si manifestim i dukshëm i autoritetit shtetëror, ku ndër detyrat më të rëndësishme të saj, është dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Prandaj dhe shërbimet policore, duhet t'i përshtaten parimeve të demokracisë, llogaridhënies dhe respektimit, të të drejtave të njeriut.

Oficerët e policisë gjithashtu, duhet të trajnohen, që të mos përdorin forcë më shumë sesa është nevojshme, kur kapin një person dhe pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim, për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen, për aq kohë sa është e nevojshme.

Sa i përket procedurave të kryerjes së ekzaminimit mjeko-ligjor në lidhje me rastet e keqtrajtimit të mundshëm të policisë, delegacioni i CPT-së gjatë vizitës monitoruese është informuar se ekzaminimi mjeko-ligjor nga instituti mund të bëhet vetëm nëse kërkohet nga policia, prokurori ose Avokati i Popullit. Personat e ndaluar, të cilët pretendohet se janë keqtrajtuar nga policia nuk kishin të drejtë të kërkonin vetë një ekzaminim mjeko-ligjor, por ata së pari duhet të raportojnë në polici ose në prokurori në mënyrë që të regjistrohej një kërkesë zyrtare. CPT thekson se një gjendje e tillë është jo në përputhje me standardet e vendosura ndërkombëtare (paragrafi 123 i "Protokollit të Stambollit").

Për këtë arsye, CPT ka rekomanduar që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të ndryshuar legjislacionin përkatës.

Në bazë të nenit 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; në nenin 21/ pikat c dh ç, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin thuhet se: “Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”.

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për identifikimin dhe fillimin e hetimit penal ndaj punonjësve të policisë, për veprën penale të “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 250 e 25 të Kodit Penal, për veprimet e kundërligjshme të kryera ndaj shtetases ***.
- Marrjen e masave nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për ndarjen e procedimit penal nr.3687/2019 në procedime të ndryshme, në kuadër të rekomandimeve të CPT-së, sipas të cilave keqtrajtimet e mundshme të policisë të hetohen nga prokurorë të cilët nuk kanë lidhje me hetimet penale kundër viktimave të pretenduara të keqtrajtuara.
- Marrjen e masave nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave të kryejë me përgjegjshmëri veprimet e nevojshme hetimore brenda afateve të arsyeshme në kuadër të këtij hetimi penal.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi na njoftoni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Bashkëlidhur ju dërgojmë me cilësinë e provave, kopje të vërtetuara me vulën e institucionit tonë të dokumenteve të mëposhtme:

1. Deklarimet e shtetases ***;
2. Dëshmi mjeko ligjore;
3. CD me pamjet filmike të marra nga mediat;
4. Korrespondencën me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
5. Korrespondencën me Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat;
6. Korrespondencën me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERE

Ermonela RUSPI

